LIGJ
Nr.9411, datë 20.5.2005

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË RUMANISË PËR ZGJIDHJEN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ RUMANISË

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë për zgjidhjen e borxhit të Republikës së Shqipërisë ndaj Rumanisë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4617, datë 6.6.2005 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
NDËRMJET QEVERISË SË RUMANISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË MBI ZGJIDHJEN E BORXHIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NDAJ RUMANISË

Qeveria e Rumanisë e përfaqësuar nga Ministria e Financave Publike dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i përfaqësuar nga Ministria e Financave (Palët), duke dashur të zhvillojnë marrëdhëniet ekonomike ndërmjet dy vendeve, kanë rënë dakord të zgjidhin borxhin e Republikës së Shqipërisë kundrejt Rumanisë, i cili rrjedh nga llogaritë klering, si më poshtë:

Neni 1

Palët kanë rënë dakord që borxhi i Republikës së Shqipërisë kundrejt Rumanisë, sipas gjendjes më 30.6.2004, është si më poshtë:

a) Borxhi në rubla të transferueshme është 15 016 966. 01;

b) Borxhi në USD klering është 300 421.44.

Kurset e këmbimit për këmbimin e rublave të transferueshme dhe të dollarëve klering në dollarë të konvertueshëm, është:

- 2.94 rubla të transferueshme = 1 USD.
- 1 USD klering = 1 USD.

Duke përdorur këto kurse, shuma e borxhit të Republikës së Shqipërisë kundrejt Rumanisë është 5 408 233.0 USD nga e cila;

- 5 107 811.57 USD rrjedh nga llogaritë në rubla të transferueshme;
- 300 421.44 rrjedh nga llogaritë USD klering.

Neni 2

Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, Qeveria rumune autorizon Bankën Tregtare Rumune (Banka).

Banka do të transferojë shumën që duhet paguar në USD në një llogari likuiduese (më poshtë quajtur "llogaria").

Neni 3

Shlyerja e totalit të borxhit në USD, siç është theksuar në nenin 1 të kësaj Marrëveshjeje, do të bëhet në USD lirisht të këmbyeshëm, me 20 këste të barabarta gjashtëmujore për një periudhë prej 10 vjetësh duke filluar nga data 20 korrik 2005.

Neni 4

Pagesat e interesat do të kryhen më 20 janar dhe 20 korrik të çdo viti, duke filluar nga korriku i vitit 2005. Mbi shumën e borxhit do të aplikohet interesi *Libor* për një periudhë 6-mujore.

"Libor" është norma e interesit për veprimet në USD në tregun ndërbankar në Londër, siç përcaktohet nga Reuter për shumat dhe periudhat përkatëse, afërsisht në orën 11.00 me orën e Londrës, dy ditë-pune përpara fillimit të periudhës përkatëse të interesit e rrumbullakosur me 1/16.

Banka Tregtare Rumune do të njoftojë Ministrinë e Financave për normën faktike të interesit dhe për udhëzimet e pagesës dhe do të konfirmojë, gjithashtu shumat e paguara të interesit të paktën një muaj përpara datës së pagesës.

Llogaritja e interesit do të fillojë në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

Banka Tregtare Rumune do të njoftojë Ministritë e Financave të të dy vendeve mbi gjendjen që është bilanci i "llogarisë" më 31 dhjetor të çdo viti, jo më vonë se 31 marsi i vitit pasardhës.

Neni 6

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin nga zbatimi ose interpretimi i kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhen në mënyrë miqësore ndërmjet Palëve.

Neni 7

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me marrëveshje me shkrim ndërmjet "Palëve".

Neni 8

1. Të dyja Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim, në rrugë diplomatike, për përmbushjen e procedurave të brendshme ligjore për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Marrëveshja do të hyjë në fuqi në datën e fundit të këtyre njoftimeve.

2. Për qëllimet e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të komunikojnë me njëra-tjetrën në adresat e mëposhtme:

Për Ministrinë e Financave të Shqipërisë Në vëmendje të: Drejtorisë së Borxhit, Ministria e Financave Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" nr.1 Tiranë, Shqipëri	Për Ministrinë e Financave të Rumanisë Në vëmendje të: Departamentit të Financave të Jashtme Publike Ministria e Financave Publike 17, Apolodor Street, Bucharest 050741

Tel: ++355 4 22 84 05 Fax: ++355 4 22 84 94	Romania Tel: ++(4021) 410 34 00 Fax: ++(4021) 312 67 92
Për Bankën Tregtare Rumune Në vëmendje të: Departamentit të Kredisë Dokumentare dhe Financimit të Tregtisë Banka Tregtare Rumune 5, Regina Elisabeta BLVD. Bucharest, Romania Tel:.++(4021) 312 41 04/55 99 Fax:++(4021) 312 41 04/55 81	

3. Kjo Marrëveshje do të mbetet në fuqi deri në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej saj. Nënshkruar në Bukuresht, më_____2004, e hartuar në dy kopje në gjuhën angleze.